



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PEQIN

Bashkia Peqin, Bulevardi "Mustafa Gjinishi", e-mail. "bashkiapeqin@yahoo.com"

Nr./056/prot.

Peqin, 23.10.2017

SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN
CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE (Specialist)

Lloji i diplomës "Shkenca te informatikes, kompjuterike, elektronike, teknologjise se informacionit, etj." niveli minimal i diplomës "Bachelor"

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, si dhe të Kreut II, IV dhe VII, të Vendimit nr.243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Peqin shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve:

1. 1 (nje) Specialist te Teknologjise se Informacionit dhe Komunikimit – kategoria III-b.

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për procedurën (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për LEVIZJE PARALELE:

04 Nnetor 2017

Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL:

09 Nentor 2017

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

1. instalon dhe mirëmban infrastrukturën e rrjetit LAN/ËAN, të sistemit telefonik, sistemit të fonisë, sistemit të kartave hyrëse-dalëse, kamerave, etj;
2. zhvillon politika dhe procedura për hyrje dhe përdorim të rrjetit kompjuterik dhe/ose të data bazës së internetit;
3. administron të drejtat e përdoruesve në rrjet;

4. zbaton masa parandaluese dhe strategji për rritjen e performancës së rrjetit kompjuterik.
5. përcakton kërkesat teknike për sistemet në ngarkim, si dhe asiston në përgatitjen e termave të referencës për informatizimin e mëtejshëm të Bashkisë Peqin;
6. kërkon, vlerëson dhe implementon programe për trafikun dhe sigurinë në rrjet;
7. monitoron performancën e rrjeteve dhe koordinon aksesin dhe përdorimin e rrjeteve;
8. instalon dhe mirëmban sistemin e telefonisë;
9. siguron shërbime për zgjidhjen e problemeve të përdoruesve të rrjetit;
10. instalon, mirëmban, zgjidh problemet dhe përmirëson aplikacionet për pajisje dhe programe;
11. kërkon, dizajnon dhe zhvillon arkitektura të sistemeve të informimit dhe komunikimit të rrjeteve;
12. ruan konfidencialitetin e sistemeve, bazave të të dhënave dhe gjithë informacioneve të tjera të trajtuara nga institucioni;
13. kryen punën për dhënien e nivelit të parë të ndihmës për të gjitha pajisjet elektronike të institucionit të Bashkisë Peqin, (servera, kompjutera, printera, scanera, sistemi i fonisë, sistemit të telefonisë, sistemi i kartave hyrëse-dalëse, kamerave, fotokopjeve, UPS, etj.);
14. siguron konfigurim dhe instalim të specializuar për përdoruesit në domain, mail server, dhe sistemet e tjera elektronike;

LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori ekzekutive;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mire”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Bachelor" në Shkencat e informatikes, kompjuterike, elektronike, teknologjise se informacionit, etj. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b- Të kenë të paktën 1 vit përvojë pune në profesion.
- c- Të ketë njohuri të gjuhës angleze.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore te Bashkisë Peqin, dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip;
- b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

- g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h - Vërtetimin nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti (dorazi) në Zyren e Protokollit dhe Arshives të Bashkisë Peqin, me adresë Bulevardi "Mustafa Gjinishi" Peqin, brenda datës 04 Nentor 2017.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 04 Nentor 2017, Bashkia Peqin do të shpallë në stenden e informimit të publikut, faqen zyrtare të internetit "www.peqini.gov.al" dhe në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Peqin, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar)
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9880, datë 25.02.2008 "Për nënshkrimin elektronik", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008, "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë";
- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 10 273, datë 29.04.2010 "Për Dokumentin Elektronik";
- Njohuritë mbi VKM nr. 357, datë 24.04.2013 "Për miratimin e rregullores për menaxhimin e dokumentit elektronik në Republikën e Shqipërisë";

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për pervojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015,

të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al. <http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Peqin do të shpallë fituesin në stenden e informimit të publikut, faqen zyrtare “www.peqini.gov.al” dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Bashkia Peqin, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimi në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta marrim në faqen zyrtare “www.peqini.gov.al”, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në stendën e informimit të publikut të Bashkisë Peqin, duke filluar nga data 17 Nëntor 2017.

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimi në shërbimin civil janë:

- a- Të jetë shtetas shqiptar;
- b- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- ç- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- ë- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor” në Shkencat e informatikës, kompjuterike, elektronike, teknologjise se informacionit, etj.. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b- Të kenë të paktën 1 vit përvojë pune në profesion;
- c- Të ketë njohuri të gjuhës angleze;

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip;
 - b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
 - c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
 - d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
 - g - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhen me poste ose dorazi në *Zyren e Protokollit dhe Arshives të Bashkisë Peqin, me adrese Bulevardi 'Mustafa Gjinishi', Peqin.*
- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive duhet të bëhet brenda datës 09 Nentor 2017.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 10 Nentor 2017, Bashkia Peqin do të shpallë në stenden e informimit të publikut, faqen zyrtare të internetit "www.peqini.gov.al" dhe në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga njësia e burimeve njerëzore të Bashkisë Peqin, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- Njohuritë mbi Ligjin Nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar)
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9880, datë 25.02.2008 "Për nënshkrimin elektronik", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë";
- Njohuritë mbi Ligji Nr. 10 273, datë 29.04.2010 "Për Dokumentin Elektronik";
- Njohuritë mbi VKM nr. 357, datë 24.04.2013 "Për miratimin e rregullores për menaxhimin e dokumentit elektronik në Republikën e Shqipërisë";

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;

b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;

c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al” <http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkisë Peqin, do të shpallë fituesin në faqen zyrtare www.peqini.gov.al, portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në stendën e informimit të publikut të Bashkisë Peqin. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen zyrtare www.peqini.gov.al, portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe stendën e informimit të publikut të Bashkisë Peqin, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive: për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak, datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, faqen zyrtare www.peqini.gov.al dhe stendën e informimit të publikut të Bashkisë Peqin duke filluar nga data 17 Nentor 2017.

P/Drejtorine Juridike

Drejtori

/ Gentian Cani /



KRYETARI BASHKISE

/ Saimir HASALLA /

